REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-641
Data/Datum/Date: 08/05/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -3-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Kabineti i Ministres – Kancelarija Ministra – Cabinet of the Minister

---

Nr.33/2026
Datë:08/05/2026

Ne mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) neni 11, nenin 29 dhe nenin 30 të Ligjit nr.06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nen-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit te Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore si dhe ne pajtim me Nenin 6 të Rregullores QRK-Nr.04/2026 për fushat e përgjegjësisë administrative të ministrive, Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Deklarata e Performancës e dhënë nga njësia përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me Raportin e Performancës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2025.

3. Vendimi hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit.

Donika GËRVALLA-SCHWARZ

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi iu dërgohet:

- *Faton Jashari, U.D. Drejtor Ekzekutiv i ANJF-së;*
- *Anëtareve të njësisë përgjegjëse;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Arkivit të MD-së.*

Deklarata e Performancës

Data:	08.05.2026
AGJENCIA	**Agjencia për Ndihmë Juridike Falas**
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	**Ministria e Drejtësisë**
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	**Po**

Vlerësimi përshkrues i performancës

Në bazë të raportit të performancës për vitin 2025, të pranuar me datë 30.03.2026, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka arritur një nivel të lartë të përmbushjes së objektivave të saj, duke dëshmuar progres të dukshëm në zhvillimin e politikave, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe zgjerimin e qasjes në drejtësi për qytetarët.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka realizuar një sërë aktivitetesh dhe ka arritur rezultate konkrete, si në vijim:

- **Zhvillimi i kornizës ligjore dhe politike** – Është avancuar procesi i hartimit të Projektligjit për Ndihmë Juridike Falas përmes punës së grupit punues dhe organizimit të punëtorive dhe takimeve përkatëse.
- **Rritja e kapaciteteve profesionale** – Janë realizuar gjithsej 33 trajnime për stafin e ANJF-së dhe partnerët, duke tejkaluar ndjeshëm objektivin e planifikuar dhe duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.
- **Identifikimi i nevojave dhe planifikimi strategjik** – Janë hartuar plane trajnimi dhe janë realizuar punëtori për planifikim strategjik dhe zhvillim institucional.
- **Zgjerimi i shërbimeve përmes partneriteteve** – Është arritur mbulimi i plotë territorial i Republikës së Kosovës përmes partneritetit me OJQ-të, ndërsa numri i përfituesve nga këto organizata ka arritur në 3,595 qytetarë, duke tejkaluar dukshëm objektivat.
- **Rritja e ndërgjegjësimit publik** – Janë realizuar 79 aktivitete informuese, përfshirë fushata të gjera si Java e Ndihmës Juridike Falas dhe aktivitetet në kuadër të "16 Ditëve të Aktivizmit", duke arritur të informohen mbi 6,000 qytetarë (dhe mbi 10,000 gjatë fushatave specifike).
- **Fokus në grupet e cenueshme** – Janë zhvilluar aktivitete të shumta për komunitetet e margjinalizuara, përfshirë shpërndarjen e mbi 2,000 broshurave dhe organizimin e takimeve informuese.
- **Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me donatorë** – Aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me institucione vendore dhe partnerë ndërkombëtarë (GIZ, UNDP, OSBE, etj.), duke rritur ndikimin e ANJF-së.
- **Digjitalizimi i shërbimeve** – Është avancuar puna për ridizajnimin e webfaqes dhe përmirësimin e bazës së të dhënave, me funksionalizim të plotë të pritur në vitin 2026.

Rezultatet e arritura gjatë vitit 2025 tregojnë një performancë shumë të suksesshme të Agjencisë, duke tejkaluar në shumë raste objektivat e planifikuara dhe duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e qasjes në drejtësi për qytetarët, veçanërisht për grupet e margjinalizuara.

Prioritetet e performancës

Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të performancës dhe përmbushjes së misionit të saj, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është fokusuar në këto prioritete:

- Finalizimin dhe miratimin e kornizës së re ligjore për ndihmë juridike falas.
- Vazhdimin e ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të avancuara dhe të specializuara.
- Thellimin e bashkëpunimit me institucionet, OJQ-të dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Zgjerimin dhe forcimin e shërbimeve në nivel lokal, me fokus në grupet e cenueshme dhe zonat e largëta.
- Përfundimin e proceseve të digjitalizimit dhe funksionalizimin e plotë të sistemeve informative.

- Përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit për të garantuar cilësi dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve.

Donika GËRVALLA-SCHWARZ

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë